

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PEJË, duke vendosur ne procedurë kundervajtëse ndaj të paraqiturit Petrit Ademaj, nga Peja, për kundervajtje nga neni 5, 6 par.1 pika 2 dhe nenit 8 par.1 të Ligjit nr.4/L-50, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, në baze te nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt.18.10.2012, bie këtë:

A K T V E N D I M

REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep		Nr Prot	
Dep		Sr Prot	
Dep	DPK/DMP	Prot No	03-4151/12
Nr. fletq		Data	
Isht. shifra		Datum	14.11.2012
Nr. pages	02	Date	

PEZULLOHET procedura kundervajtëse ndaj të paraqiturit Petrit (Mustafë) Ademaj, i lindur me dt.02.07.1967, nga Peja, Rr.Gjergj Fishta, nr.60, për kundervajtje nga neni 5, 6 par.1 pika 2 dhe nenit 8 par.1 të Ligjit nr.4/L-50, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, në baze te nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, Dep.i Parandalimit, Prishtinë, me kërkesën Nr.01-1811-12 të dt.18.05.2012, ka kërkuar nga Gjykata zhvillimin e procedurës kundervajtëse kundër të pandehurit Petrit Ademaj nga Peja, për kundervajtje nga neni 5, 6 par.1 pika 1.2 dhe nenit 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-150 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Kjo gjykatë duke vepruar sipas kërkesës së lartcekur, e ka dëgjuar të pandehurin i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se gjerë me datën 31.12.2011, ka qenë i përcaktuar në pozitën e shefit të departamentit të Internos në kuadër të Spitalit Regjional në Pejë, dhe e ka të kryer obligimin e tij ligjor për deklarimin e pasurisë brenda afatit ligjor, ndërsa që nga data 01.01.2012 nuk e ushtron pozitën e shefit të departamentit të Internos dhe është i përcaktuar në punët dhe detyrat e punës si mjekë në Njësinë Koronare në kuadër të Repartit Internistik pranë Spitalit Regjional në Pejë, duke i prezantuar gjykatës në shiqim formularin për deklarimin e pasurisë me datë të dorëzimit 31.03.2011 si dhe kontratën e marrëdhënies së punës, me kërkesë nga gjykata që me rastin e vendosjes ta ketë parasysht deklaratën e tij.

Meqenëse i pandehuri që nga data 01.01.2012 nuk e ushtron pozitën e shefit të departamentit të Internos por është i përcaktuar në punët dhe detyrat e punës si mjekë në Njësinë Koronare në kuadër të Repartit Internistik pranë Spitalit Regjional në Pejë, në kuptim të nenit 3 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.04/L-150 që ka të bëjë me përkufizimet e Zyrtarëve të Lartë Publik, i paraqituri nuk ka për obligim deklarimin e pasurisë në vështrim të nenit 8 të Ligjit 04/L-150, andaj në kuptim te nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

NGA GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PEJË,

Regj.Nr.5-5961/12, më dt.18.10.2012



1 1 8/17

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa
Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë,
në afatin prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij
aktvendimi e nëpërmes të kësaj Gjykate